



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9.3.2023

Nr: 159

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 79, DATË 1.3.2023, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, "PËR AKREDITIMIN E VEZHguesVE AFATGJATË TË KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 9.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit me seli në Tiranë,

Rruga "Brigada e VIII" me përfaqësuese zj. Erida Skëndaj

OBJEKTI: Për një shtesë në vendimin nr. 79, të datës 1.3.2023, për akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave"

Data: 9.3.2023 Nr: 159
Ora: 10:00



"Për një shtesë në vendimin nr. 79 datë 1.3.2023 të Komisionerit, "Per akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023"

V Ë R E J:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Me vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, janë akredituar 28 (njëzet e tetë) vëzhgues afatgjatë. Në kërkesën e paraqitur më datë 2.3.2023, kërkohet një shtesë për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatgjatë.

Në zbatim të nenit 64 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pala që ka dorëzuar një kërkesë mund t’ a plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 19, datë 27.1.2023 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave ”,

V E N D O S:

1. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 2 (dy) vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shtesa e miratuar do t’ i shtohet listës nr. 1 të vëzhguesve afatgjatë, të miratuar në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të ndryshuar.

Data: 9.3.2023 Nr: 159
Ora: 10:00



“Për një shtesë në vendimin nr. 79 datë 1.3.2023 të Komisionerit, “Per akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

